

# Shpresë

Botim i Shoqatës "Shpresë për të Ardhmen"



# TRYEZA E LENDES

Viti që lamë pas - **3**

Përsiatje mbi migrimin - **4,11**

Mbyllja e projektit ALBAMAR - **6**

Informacion nga zyra e Shkodrës - **7**

Shtëpi, e ëmbla shtëpi - **8**

Çdo njeri mund ta ndërtojë jetën në vendin e tij - **10**

Forcimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme - **12**

Rezultatet dhe arritjet e Projektit Migravalue - **13**

Projekti “Çel një shteg në jetë” - **16**

Letra falenderimi - **17**

Statistika - **19**



Botim i Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”  
Nr. 13- Prill 2009

Redaktimi: **Irena Dono**  
Realizimi grafik: **Eduart Cani**  
Fotot: **Kristaq Jorgaqi**  
Shtypi: **Gent Grafik**

## Viti që lamë pas

Ra sipari i vitit 2008 dhe bashkë me të u mbyll një vit plot punë e përpjekje për të realizuar objektivat tona. Viti që lamë pas shënoi fazën përfundimtare të shumicës së projekteve të shoqatës. Projekti me kohëzgjatje trevjeçare ALBAMAR ofroi një mbështetje të integruar për emigrantët shqiptarë të kthyer nga Italia. 254 emigrantë të kthyer u asistuan nëpërmjet këtij projekti me shërbime punësimi dhe trajnimi profesional. Një numër jo i pakët përfituan këshillim psikologjik, ligjor si edhe këshillim për hapje biznesi të vogël. U bënë hapat e para për të krijuar një shoqatë të emigrantëve të kthyer, të interesuar të zhvillojnë aktivitete social- kulturore dhe të dalin në mbrojtje të të drejtave të tyre.

Projekti “Kape të Ardhmen” ofroi shërbime punësimi dhe aktivitete për riintegrimin social për 72 emigrantë të kthyer nga Zvicra dhe Gjermania. Asistenca për riintegrim zgjati për një periudhë nëntëmuajore.

Projekti “Çel një shteg në jetë” i zbatuar në fshatin Bërxullë të Bashkisë së Vorës u dha mundësi 55 grave dhe vajzave të asaj komune të kryenin kurse formimi profesional në rrobaqepësi, parukeri, kuzhinë dhe kompjuter, duke i përgatitur ato për tregun e punës.

6 emigrantë të kthyer vullnetarisht nga Mbretëria e Bashkuar u asistuan nga Projekti “VARRP” dhe 1 emigrante e kthyer nga Belgjika me djalin e saj u ndihmuan nëpërmjet projektit “Asistencë e Individualizuar Riintegrimi pas Kthimit Vullnetarisht”.

40 emigrantë të kthyer përfituan trajnime për hapje biznesi ose forcim kapaciteti të një biznesi ekzistues. 10 emigrantë të kthyer u mbështetën financiarisht për të hapur një biznes të ri.

Në muajin gusht përfundoi edhe projekti “MIGRAVALUE”, në kuadrin e të cilit u hartuan 5 paketa studimore që vlejné për të analizuar një strukturë të menaxhuar të dukurisë “migrant”, si edhe për të vënë në pah shërbimet dhe politikat për një menaxhim aktiv të lëvizjeve migratore dhe për të bërë promovimin e zhvillimit lokal.



Viti 2009 na gjen kështu me një bilanc pozitiv arritjesh dhe zhvillimi, po paradoksalisht me një varfëri projektësh. Kjo na vë përpara sfidash të mëdha për të çelur shtigje të reja në problematikat e mëdha që ka aktualisht shoqëria shqiptare si edhe për të intensifikuar kërkimet për donatorë potencialë që të mbështesin projektet tona të ardhshme. Përvoja e deritanishme në punën me emigrantët e kthyer dhe migrantët e brendshëm, sidomos me gratë, na ka mësuar se çfarë është parësore dhe ku duhet të ndërhyjmë, por thellimi në problematikat është me sa duket i domosdoshëm.

Gjatë vitit 2009 ne do të vazhdojmë të punojmë me Projektin “Kape të Ardhmen”, duke u përqëndruar në zonat rurale dhe duke asistuar emigrantë të kthyer që jetojnë në ato zona.

Me këtë rast dëshiroj t'i shpreh një falenderim të veçantë donatorit afatgjatë të projektit, HEKS (Ndihma e Ndërkishës Zvicrane), i cili qysh nga viti 1999 na ka mbështetur në vazhdimësi, si edhe Z. Patrice de Mestral, i cili ka qenë bashkudhëtar, mbështetës dhe kontributor në udhën tonë të zhvillimit.

**Irena Dono**  
**Drejtoresh e Ekzekutive**



## Përsiatje mbi migrimin

*Irena Dono*

### *Migrimi si dukuri dhe migrimi në Shqipëri*

Migrimi si fenomen mbarëbotëror është një dukuri e hershme që i ka prekur tërë popujt në rruzull. Në kohëra të ndryshme migrimi ka pasur përmasa të ndryshme, po çka është e njëjtë është se migrimi është një vozitje drejt një bote tjetër që mund të të ofrojë diçka më shumë se mjedisi ku jeton, është një fluturim drejt një ëndrre që gjithkush shpreson t'i kthehet në realitet dhe askush nuk mendon se mund të

ketë nga pas ose suksesin ose zhgënjimin.

Migrimi në Shqipëri si dukuri është njohur në fillimet e shekullit të nëntëmbëdhjetë, paçka se shumë shekuj më parë shqiptarët kanë lëvizur e shërbyer në vende të ndryshme të botës dhe sidomos në perandorinë osmane. Po padyshim migrimi më i madh i shqiptarëve ka ndodhur pas vitit 1990 e në vazhdim. Për një numër jo të vogël shqiptarësh ky emigracion i vonë ishte një ikje nga sytë këmbët, ishte si dehje nga liria, ishte një gjendje deliriumi që nuk zgjati shumë,

por mbaroi sa ranë në kontakt me realitetin e ri. Beteja për jetën ishte shumë më e vështirë në dheun e ri.

Ndodhi pikërisht ajo që ne nuk mund ta përfytyronim dot më parë: pothuajse çdo familje shqiptare ka nga një pjesëtar në emigracion.

### *Shkaqet e migrimit*

Shkaqet e migrimit nuk ndryshojnë shumë nga njëri popull në tjetrin, madje janë pothuaj të njëjta: varfëria ekonomike, papunësia, pasiguria e jetës, mungesa e perspektivës, dëshira individuale për të parë,

njohur e jetuar në një botë më të mirë, dëshira për të pasur një shkollim më të mirë etj. Po nëse në botë zakonisht migrojnë të rinjtë, shqiptarët migruan edhe në moshë të mëdha, me motivin e vetëm se sakrikuan për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Kjo mendoj se e bën të veçantë, krahas përmasës, migracionin shqiptar.

### *Migrimi si dukuri pozitive*

Migrimi ka sjellë shumë gjëra pozitive për shqiptarët. Së pari u dha mundësinë të ballafaqoheshin me një botë ndryshe, me një sistem të ndryshëm nga ai që ishin mësuar ta jetonin për afro 50 vjet, të matnin forcat me atë botë dhe të provonin sa të aftë ishin të përshtateshin me të. Pra ishte një sfidë jete që jo të gjithë arritën t'i bëjnë ballë.

Shumicës së tyre që u larguan në periudhat më kritike të anarkisë së tranzicionit shqiptar iu desh të bënin përpjekje të mëdha t'u nënshtroheshin rregullave të shoqërive të vendeve pritëse, pra të vepronin në përputhje me ligjet

vendase. Dhe shumica syresh arriti që të përshtatet.

Migrimi ndihmoi që ekonomia shqiptare të përmirësohet. Të ardhurat e emigrantëve vërtet kanë shkuar për të përmirësuar ekonominë individuale të familjeve shqiptare dhe më pak në investime të mëdha, po prapë se prapë kjo ka ndikuar gjithaq në ngritjen e ekonomisë në përgjithësi. Migrimi u krijoi mundësinë të gjenin një punë dhe të kursenin para për t'ua dërguar edhe familjarëve të tyre në Shqipëri. Migrimi u krijoi edukatën dhe kulturën e punës dhe u krijoi besimin se pa punë nuk arrihet asgjë. Migrimi u mësoi të ulnin kokën dhe të bënin çdo lloj pune gjë që në Shqipëri nuk denjonin ta bënin. Migrimi u dha mundësinë të shkolloheshin, të edukoheshin ndryshe dhe të ndryshonin botëkuptimin. Migrimi u mësoi rregullat e etikës dhe mirësjelljes, të cilat kishin filluar të harroheshin në Shqipëri. Migrimi bëri që shqiptarët të mësonin gjuhë të huaja, çka ishte diçka e rrallë të bëhej më parë, kur kontaktet me botën ishin të pakta dhe gjuha e huaj mbetej si

eksperiment laboratorik, pa mundur të praktikohet.

### *Pasoja negative të migrimit*

Migrimi solli edhe pasoja negative si: struktura e familjes shqiptare u shpërbë dhe kjo ndikoi pastaj edhe në edukimin e fëmijëve, shtimin e numrit të divorceve etj.

Pamundësia për të gjetur punë e jetuar jashtë i bëri një pjesë shqiptarësh të merren me aktivitete të paligjshme si trafiqet e drogës, fëmijëve dhe prostitucionit. Dëshira e ethshme për të fituar para të madhe në mënyrë të shpejtë i shtyu disa të tjerë në aktivitete kriminale të përmasave më të mëdha. Integrimi në botën bujtëse bëri që të thelloheshin kontradiktat prindër-fëmijë. Duke e pasur më të lehtë përshtatjen, fëmijët filluan të distancoheshin nga prindët dhe, madje duke mos pasur kohë të komunikonin me ta, të harronin gjuhën amtare, çka është për mua dëshpëruese. Druaj se herët a

**vijon në faqen 11**





## Mbyllja e projektit ALBAMAR

Në vitin e tretë dhe të fundit Projekti ALBAMAR vazhdoi me objektivat e tij për të krijuar një mbështetje të integruar për emigrantët shqiptarë të kthyer nga Italia. Gjatë vitit 2008 u ndihmuan me shërbime punësimi 59 të rinj të riadhesuar si edhe morën këshillim të specializuar psikologjik dhe ligjor 12 persona.

Ky projekt u zbatua edhe në Marok për emigrantë marokenë të kthyer nga Italia në vendin e tyre të origjinës.

Një nga objektivat e projektit ALBAMAR ishte krijimi i shoqatës së emigrantëve të kthyer, e cila mendohej të gruponte këta njerëz me probleme pothuaj të ngjashme, për arsye të emigrimit që paraqet të njëjtat problematika, por edhe me interesa nganjëherë të ndryshme për shkak të riintegrimit jo të barabartë në shoqërinë shqiptare pas kthimit. Përpjekjet e para u bënë, u arrit të krijohesh një bërthamë të rinjsh të interesuar të organizoheshin, por ende kjo s'ka marrë status ligjor, çka do t'u jepte këtyre njerëzve më tepër motive për t'u organizuar dhe vepruar së bashku.

Më 21 nëntor 2008 u organizua në Milano nga organizata italiane COOPI, e cila drejtonte projektin, konferenca finale që shënoi mbylljen e projektit ALBAMAR. Në këtë konferencë merrnin pjesë të gjitha organizatat partnere, të cilat evidentuan punën e bërë në këtë projekt, nxorën në pah arritjet dhe

mosarritjet si rezultat i vështirësive të kaluara si edhe dhanë rekomandime për të ardhmen.

Interesante ishte të vihej re qasja që i kishin bërë projektit në shërbimin bazë organizatat implementuese të projektit, ajo marokene AFVIC dhe shoqata jonë "Shpresë për të Ardhmen", të cilat kishin vepruar në përputhje me kushtet specifike të vendit.

AFVIC kishte ofruar asistencë për riintegrim, duke u dhënë mundësi grupeve të të kthyerve të trajnoheshin pranë ndërmarrjeve artizanale dhe bizneseve të ndryshme, ndërsa shoqata jonë kishte lehtësuar punësimin e individëve pranë bizneseve kryesisht të vogla, aty ku ata kishin bërë praktikën e punës.



Foto nga konferenca përfundimtare



## Informacion nga zyra e shoqatës në Shkodër

Shoqata “Shpresë për të Ardhmen” dega Shkodër, vazhdoi edhe gjatë vitit 2008 punën për implementimin e Projektit “ALBAMAR, por duke qenë e hapur edhe për projektet e tjera të shoqatës. Duhet theksuar se gjatë këtij viti patëm një numër më të madh përfituesesh femra se vitet e kaluara. Mosha e përfituesve varion nga 23 deri në 41 vjeç dhe arsimit i tyre është tetëvjeçar dhe i mesëm, por nuk përjashtohen edhe raste përfituesish që vazhdojnë studimet e larta në Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër.

Emigrantëve të kthyer u janë ofruar shërbime punësimi dhe trajnimi, asistencë psikologjike dhe ligjore, këshillim për hapje biznesi të vogël si edhe janë organizuar aktivitete të ndryshme sensibilizuese, ku disa prej tyre kanë qenë pjesëmarrës dhe kanë dhënë ndihmesë në debatet e zhvilluara në shkolla.

Gjatë vitit të kaluar u organizuan gjithashtu disa aktivitete social-kulturore si përshembull takimet e quajtura “Shtëpia e Hapur” ku synohet që klientët të njihen me njëri-tjetrin, të marrin informacion për aktivitetet dhe shërbimet tona, të shkëmbejnë eksperiencat e jetës dhe të japin mendime se si mund të organizohen më shumë aktivitete që lehtësojnë riintegrimin e tyre në shoqëri; ndeshje futbollit me klientët meshkuj, takim me një grup zviceran ku u diskutua për situatën në Shqipëri, vështirësitë që hasin emigrantët e kthyer në procesin e riintegritimit dhe për shërbimet e ofruara nga stafi i shoqatës etj.

Duhet theksuar se gjatë gjithë kohës qysh prej hapjes së saj e në vazhdim zyra e Shkodrës ka pasur një numër të madh vizitorësh, të cilët kanë shprehur interesim të marrin pjesë në programin e shoqatës. Me mbylljen e projektit “ALBAMAR”, duhet thënë se janë zvogëluar mundësitë për të asistuar një numër të madh emigrantësh të kthyer, por sidoqoftë ne shpresojmë se do të gjenden mundësi të reja për donacione.



**Imelda Aga**  
**Punonjëse sociale**



## Shtëpi, e ëmbla shtëpi

Po e filloj këtu historinë e jetës sime: Pasi kreuva gjimnazin “Oso Kuka” në Shkodër, studjova një vit për juridik në Tiranë, por, për shkak të kushteve të vështira u detyrova të ndërprisja studimet dhe të ndihmoja familjen duke hapur një biznes të vogël, nga i cili nxirrja të ardhura sa për të jetuar. Por pasi biznesi nuk shkonte siç duhej dhe unë më shumë vija vërdallë se sa punoja, si shumë të rinj të asaj kohe fillova të vihesha në kërkim të një personi që mund të më çonte diku në Evropë.

Pasi e gjeta këtë person, me paratë që familja kishte kursyer nga puna e deriatëhershme, me një pasaportë të dikujt tjetër, në qershor të vitit 1995, emigrova në Gjermani.

Menjëherë pas mbërritjes në aeroportin e Frankfurtit, e zhduka dokumentin me të cilin isha pajisur. Shokët që më pritën më informuan

dhe më sqaruan për shumë gjëra që m'u dukën të çuditshme e që veç nëpër filma mund t'i kisha parë...

U regjistrova si kosovar në një qendër ku kishte emigrantë nga shumë vende të tjera evropiane dhe jo evropiane. Arrita të gjeja edhe punë; punova shumë për vite me radhë dhe paguhesha pak, por, sidoqoftë, isha i kënaqur se mund të kurseja diçka dhe të ndihmoja familjen time në Shqipëri.

Në fillim të vitit 1999 u njoha me atë që më pas u bë bashkëshortja ime, por në fund të atij viti u arrestova nga policia gjermane në shtëpinë e saj dhe u dërgova në burg, për arsye të identitetit të rremë. Për fatin tim të keq, në Janar të vitit 2000 më kthyen në Shqipëri.

Pas shumë ecejakeve, në fund të tetorit të po atij viti u riktheva në Gjermani, në "qytetin tim" Essen. Them qytetin tim, sepse jetova disa vjet dhe u mësova aty. Bëra martesën me vajzën që, për hir të së vërtetës, e doja vërtet, dhe jo thjesht për dokumentet.

Pas 4 vitesh martese, pa pasur fëmijë, u ndava nga gruaja, për arsye të cilat janë private dhe dua t'i rezervoj për veten time.

Dy vjet rashë në depresion për shkak të kësaj ndarjeje dhe arsyes të tjera...

Në Maj të vitit 2006, mbas një ngatërrese në

një klub, u godita dhe u ofendova rëndë nga dy arabë. Reagova edhe unë ashpër dhe godita me shishe njërin prej tyre, i cili u plagos rëndë. U dorëzova në policinë rajonale, pa e ditur se ç'kisha bërë tamam.

Pas 8 muajsh mësova të vërtetën për ndodhinë dhe pas dy seancave gjyqësore u dënova me 5 vjet heqje lirie. Një vit e bëra në burgun e Bochum-it, një vit e gjysmë në atë të GelsenKirchen-it.

Sipas ligjit gjerman për të huajt, pasi vuajta gjysmën e dënimit, pra dy vjet e gjysmë më rikthyen në Shqipëri në Nëntor të vitit 2008.


Më vjen keq që ndodhi një gjë e tillë, por ndoshta kjo mund t'i ndodhte çdo shqiptari, për shkak të temperamentit, por megjithatë nuk dua të justifikoj veten, kjo nuk duhet të kishte ndodhur.

Tani jam në Shqipëri te njerëzit që më duan dhe i dua e që për vite me radhë më mungonin. Shqipërinë e shoh të ndryshuar dhe çdo ditë më mirë po bëhet e shpresojmë që të mos jetë e largët dita kur do të jemi pjesëtarë të Evropës.

Po e mbyll me një thënie të vjetër: "Të jesh mik diku është bukur, por më mirë të jesh në shtëpinë tënde"...

**A. K. (Shkodër)**





## Çdo njeri mund ta ndërtojë jetën në vendin e tij

Po ju tregoj pak nga jeta ime dhe historia ime e emigracionit, e cila ndoshta nuk është shumë e ndryshme nga historitë e tjera të bashkatdhetarëve të mi.

Pas peripecive të shumta që kisha hequr për vite të tëra në Zvicër dhe Itali si pasojë e mungesës së dokumenteve, vendosa të kthehesha për të aplikuar për vizë për të vazhduar studimet në Itali, duke menduar se kështu do t'i jepja fund jetës së një emigranti ilegal.

Pas shumë mundimesh m'u dha mundësia që të jem emigrant i rregullt. Fati më buzëqeshi dhe mendova se ditën që mora vizën do ta kujtoja si fundin e peripecive të mia, por në fakt nuk ndodhi kështu. Pas mbërritjes sime atje, shumë shpejt kuptova se edhe me dokumente jeta në Itali nuk ishte shumë e ndryshme nga ajo e mëparshmja.

Ndenja për afro 3 vjet duke vazhduar studimet, por më kot, se gjatë gjithë kohës isha në punë dhe më ngelej shumë pak kohë për të studjuar. Arrita të merrja disa provime, por ishin akoma shumë të tjera për të marrë. Kur shihja ndonjë nga shokët e mi që kishte mbaruar shkollën, më hipte dëshira ta mbaroja edhe unë, por, kur vija re që edhe pas diplomës jeta e tyre ishte po njësoj, për shkak se nuk gjenin dot punë, atëherë vendosa që të mos e ngushëlloja më veten duke ndenjtur në Itali dhe duke shpresuar që një ditë do të rregullohesha vërtet.

U ktheva sërish në vendin tim me dëshirën t'ia filloja nga e para, por kësaj here në Shqipëri. Disave prej shokëve të mi iu duk i nxituar ky vendim i imi, por më vonë më dhanë të drejtë. U ktheva në Berat dhe, me ato pak pará që kisha kursyer, por gjithashtu edhe me ndihmën e Shoqatës "Shpresë

për të Ardhmen, arrita të hapja një dyqan me qira. Si fillim e kisha të vështirë, sepse kisha vite që nuk jetoja në Shqipëri dhe nuk e njihja mirë tregun këtu, por isha i vendosur që nuk do të ikja më.

Pas disa muajsh arrita të isha njësoj si në Itali, por kësaj here isha pranë familjes. Mbase këtu niveli i jetesës është diçka më ndryshe se në Itali, por, ama, isha i bindur se nuk do ta ndjeja më kurrë atë ftohtësi dhe indiferentizëm që përjetova atje. *Shqipëria është një vend i varfër dhe e ardhmja është e brishtë, por po ju them se çdo njeri mund ta ndërtojë jetën e tij këtu, duke filluar si unë ose si shumë të tjerë që kanë vendosur të jetojnë këtu dhe ju duhet vetëm pak këmbëngulje dhe vullnet.*

Ndoshta do të doja që shteti t'i jepte më shumë shanse njerëzve që të jetojnë në vendin e tyre, por sidoqoftë unë arrita të jem njëherë i lumtur në vendin tim.

**Shyqyri Kërpica,  
Berat**



## Përsiatje mbi migrimin

*vijon nga faqja 5*

vonë do të vijë edhe asimilimi i shqiptarëve, çka nuk ndodhi në rrjedhën e shekujve. Shqiptarët u përpoqën të ruanin traditat dhe zakonet dhe t'u mbijetonin stuhive. Por tani pakkush mendon për patriotizëm, sepse konsiderohet si i dalëboje dhe produkt i një epoke që kaluam.

***Po a ndihmohen këta njerëz të gjejnë vendin e tyre në shoqërinë e ndryshuar shqiptare?***

Duhet thënë pak ose aspak; kjo sepse Shqipëria nuk ka ende struktura pritëse dhe kapacitete që t'i trajtojë këta emigrantë të kthyer. Për më tepër shoqëria shqiptare ende është në një turravrap marramendës ku njerëzit luftojnë të sigurojnë jetesën me të gjitha mënyrat, pasi e kanë të vështirë të parashikojnë se ç'do të ndodhë të nesërmen me ta. Ligjet ndryshojnë shpesh dhe kjo shkakton konfuzion dhe pasiguri. Në këtë turravrap

emigrantët e kthyer kalojnë pa u vënë re, nuk u kushtohet vëmendje në një kohë që ata kanë shumë nevojë për mbështetje.

Nuk mund ta harroj se ç'më tha një ditë një emigrant i kthyer nga Greqia ku kishte jetuar për 14 vjet: "Nuk e di se ç'do të kishte ndodhur me mua nëse nuk do të kisha gjetur mirëkuptimin dhe mbështetjen e shoqatës suaj. Ju jam vërtet shumë mirënjohës." Ishte në një gjendje shumë të rënduar psikologjike, për shkak të eksperiencave të hidhura dhe ngjarjeve vërtet traumatike, ndaj kishte nevojë ta dëgjonin dhe përkrahnin.

E keqja jonë sot është se nuk kemi më durim të dëgjojmë njëri-tjetrin dhe e kemi harruar fjalën "solidaritet".

Ka aq shumë për të thënë dhe bërë në këtë shoqëri që ndryshon parreshtur...

**Irena Dono**



## Forcim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme

Ky projekt me një kohëzgjatje njëvjeçare, i financuar nga EED (Ndihma për Zhvillim e Kishës Evangjelike Gjermane), i zbatuar gjatë vitit 2008 kishte si qëllim të ofronte shërbime të specializuara për emigrantët e kthyer dhe migrantët e brendshëm, përfitues të projekteve të shoqatës si edhe për punëdhënësit e tyre.

Në kuadër të këtij projekti u ngritën kapacitetet e 20 punëdhënësve që ofrojnë punësim për përfituesit e shoqatës, duke zgjeruar njohuritë e tyre për manaxhimin dhe planifikimin strategjik të biznesit. Shoqata jonë mundësoi pjesëmarrjen e tyre në pesë sesione trajnimi me ekspertë të fushës së biznesit në këto drejtime: *“Planifikimi dhe strategjia”*, *“Regjistrimi i një biznesi”*, *“Klientela dhe furnitorët”*, *“Marketingu dhe shërbimet”* si edhe *“Regjistrimi i veprimeve financiare”*.

Gjithashtu mbështetje për ngritje kapaciteti iu ofrua 20 përfituesve – migrantë të kthyer dhe të brendshëm me anë të një trajnimi dyjavor, i cili dha informacion mbi mënyrat e hapjes dhe manaxhimit të një biznesi. Tematika e këtij cikli trajnimesh ishte e gjerë dhe trajtoi një pjesë të konsiderueshme të çështjeve që lidhen me procedurat e biznesit, çështje që lidhen me fushën e sipërmarrjes dhe sistemin e kreditimit në Shqipëri. Pas trajnimit mbi çështjet e biznesit, dhjetë prej tyre u përzgjedhën për t’u mbështetur financiarisht për hapjen e një biznesi / aktiviteti gjenerues të ardhurash me shumën 1050 Euro prej të cilës 70% ishte grant dhe 30% hua, por pa normë interesi. Bizneset që u financuan ishin: parukeri, rrobaqepësi, qendra interneti, bar kafe, videotekë, fast food dhe mbjellje e kultivim kulturash bujqësore.

Me qëllim që të realizohej shkëmbim informacioni ndërmjet punëdhënësve/punëmarrësve dhe institucioneve që ofrojnë shërbime për zhvillimin e biznesit u organizuan dy seminare trajnimi (në Qershor dhe Dhjetor 2008). Qëllimi i këtyre seminareve ishte që të mblidhnin së bashku ente publike, institucione kreditimi, përfitues të shoqatës për të diskutuar për çështjet që lidhen me zhvillimin e biznesit dhe për të ndarë eksperiencat më të mira të bizneseve të sukseshme. Në këto seminare morën pjesë përfaqësues nga Bashkia e Tiranës, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, banka të ndryshme që japin kredi dhe nga shoqata që veprojnë në fushën e biznesit.

Pas një monitorimi të vazhdueshëm nga stafi i Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” rezulton se të gjithë përfituesit e mbështetur financiarisht vazhdojnë aktivitetet e tyre fitimprurëse, madje disa prej tyre janë duke zgjeruar dhe përmirësuar shërbimet që ofrojnë.

**Monika Hasani**

## Rezultate dhe arritje të Projektit MIGRAVALUE



Projekti *Migravalue: Drejtimi i Strukturës Sociale dhe Ekonomike në Hapësirën CADES: Vlerësimi i Migrimit si Mjet Zhvillimi*, pjesërisht i financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet programit INTERREG IIIB CADES për periudhën kohore Shtator 2006 – Gusht 2008, arriti të hartojë propozime konkrete për të ndërlidhur lëvizjen dhe interesat personale të emigrantëve me kërkesat lokale për zhvillim.

Duke i mbështetur rezultatet e veta në një hulumtim të hollësishëm të ndikimit të migrimit në zhvillimin social-ekonomik, projekti MIGRAVALUE shtron një propozim veprimi dyplanësh, të lidhur ngushtësisht me politikën, duke i dhënë kësaj përgjigje synimit të projektit për strukturimin e mënyrave për vënien në përdorim eficient të dërgesave në të mirë të individit, familjes, dhe kërkesave social-ekonomike të komunitetit.

Nën drejtimin e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë të Veneto-s dhe Dhomës së Tregtisë Italo-Slllovaqe, projekti **Migravalue** hartoi modelin “Përdorimi i dërgesave për zgjerimin e mundësive për marrjen e kredisë në vendet e origjinës: model ndërkombëtar për të vendosur lidhjen ndërmjet migrimit dhe zhvillimit lokal”, sistem shumëplanësh garancie, që vepron në nivel ndërkombëtar, që përdor transfertat e dërgesave dhe burimet e emigrantëve për të shtuar kreditë për financimin e sipërmarrjeve në vendet e origjinës. Në hartimin e këtij modeli kontribut të vlefshëm dhanë dhe ekspertët e Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” me anë të raportit kombëtar “*Analizë Studimore e Fondeve Ekzistuese Ndërkombëtare të Garancisë dhe Praktikave të Mira në Shqipëri*” i cili u përfundua në Shkurt 2008.

Vlerësimi i përmasave shoqërore të ndikimit

të migrimit ndërkombëtar në zhvillimin lokal u krye nën përgjegjësinë e Autoritetit Rajonal të Emilia-Romagna dhe Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”. Migravalue mori në konsideratë ndikimin e dërgesave të emigrantëve në zhvillimin human dhe të komunitetit në vendet e origjinës dhe zhvilloi orientime për veprim për rritjen e efektit të tyre në sektorët socialë: Nxitja e ndikimit të dërgesave në zhvillimin e komunitetit: puna në Shqipëri dhe migrimi në Itali.

Propozimet për veprim të projektit Migravalue u mbështetën në rezultatet e kërkimeve sasiore dhe cilësore të ndikimit të migrimit dhe dërgesave në mënyrën e shpenzimit, kursimit dhe investimit të familjeve shqiptare, sikurse edhe në strukturën familjare.

Migravalue u mbështet në besimin se mundësia që u jepet emigrantëve për të punuar dhe transferuar burimet ndërmjet vendeve të origjinës dhe destinacionit është parakushti primar për të vendosur lidhjen midis migrimit dhe procesit të zhvillimit lokal.

Në kuadër të planit të komunikimit të projektit Migravalue, Shpresë për të Ardhmen në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta organizoi Seminarin Rajonal “Dërgesat e Emigrantëve dhe Zhvillimi Lokal në Shqipëri” në 9 Maj 2008.

Ky seminar shërbeu si një rast shumë i mirë për konsultime publike mbi modele operative, për të shkëmbyer opinione nga politikëbërësit dhe aktorët përgjegjës mbi rolin e dërgesave të migrantëve në zhvillimin lokal të vendit.

Rezultatet e projektit Migravalue u diskutuan në Grupin Qëndror të përbërë prej shumë aktorësh, zgjedhur nga projekti me institucionet që janë pjesë e Strategjisë Kombëtare për Migracionin, ku u arrit formulimi i orientimeve për veprim në të ardhmen.

Në fund të projektit (Qershor–Gusht 2008) u organizuan një sërë seancash trajnimi tradicional dhe në distancë mbi funksionimin e modeleve të hartuara nga projekti Migravalue. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte që të ofronte një paraqitje të projektit nga perspektiva ekonomike dhe njohja me të gjitha aspektet e politikave sociale që i adresohen migrantëve dhe familjeve të tyre në vendet e origjinës.


Në këto trajnime u përfshinë partnerë të projektit Migravalue, nëpunës publikë në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar, aktorë të fushës së migracionit dhe zhvillimit ekonomik, përfaqësues nga shoqëria civile etj.

Për të bërë publike të gjitha arritjet e projektit, në 26 Qershor 2008, u zhvillua konferenca finale e projektit Migravalue në Romë. Gjatë kësaj konference u prezantuan synimet dhe arritjet e projektit duke i krahasuar me eksperiencat të mëparshme të së njetës fushë në BE dhe vendet fqinje. Shoqata “Shpresë për të Ardhmen” kishte ftuar si folës specialë në këtë aktivitet të rëndësishëm përfaqësues nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, të cilët prezantuan disa masa të marra nga Qeveria shqiptare në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Dërgesat e Migrantëve dhe Situatën e Punësimit në Shqipëri.

**Monika Hasani**



# Publikime të MIGRAVALUE





## Projekti “Çel një shteg në jetë”

**Hapat që janë hedhur në fushën e integrimit gjinor, për fat të keq, janë ende të pakta. Gruaja vazhdon të vuajë të qenit e papunë, mungesën e informacionit, dhunën në familje dhe stereotipet e jetës patriarkale, sidomos në zonat rurale. Për të zgjidhur disa nga këto problematika, Shoqata “Shpresë për të Ardhmen” në vitin 2006 zbatoi projektin pilot “Hidhe Hapin” me gratë migrante të brendshme të zonës së Laknasit. Rezultatet dhe impakti i projektit u vlerësuan si shumë pozitivë dhe i dhanë shtysë realizimit të fazës së dytë.**

“Çel një shteg në jetë” është vazhdimësi e projektit “Hidhe Hapin”, i cili u zbatua në periudhën Janar – Dhjetor 2008. Ky projekt synonte të lehtësonte integrimin e grave migrante të brendshme nëpërmjet ofrimit të mundësive për formim profesional, me qëllim që t’i bënte ato të afta të konkuronin në tregun e punës. Ne gjithashtu synonim të ofronim mbështetje psikologjike dhe emocionale si edhe të nxisnim pjesëmarrjen aktive të kësaj kategorie në jetën social – kulturore të vendit.

Projekti “Çel një shteg në jetë” mbështeti 55 gra dhe vajza në zonën e Bërxullës. Pas vitit 1990 Komuna e Bërxullës konsiderohet një nga zonat më të prekura nga migrimi i brendshëm. Nga të dhënat e grumbulluara rezulton se familjet e vendosura në Komunën Bërxullë përbëjnë 42% të popullsisë. Niveli i arsimit është i ulët, ndërsa niveli i papunësisë kap shifrën 43%.

Gratë dhe vajzat e përfshira në projekt i përkisnin grupmoshës 17-45 vjeç, nuk zotëronin asnjë profesion si edhe nuk kishin mundësi ekonomike për t’u



kualifikuar. Ato u ndihmuan të ndiqnin kurse kualifikimi në degët e mëposhtme: 16 gra u diplomuan në kursin e rrobaqepësisë; 11 në parukeri; 6 në kuzhinë; 10 në kompjuter dhe 12 në gjuhën angleze.

Kurset u ndoqën me interes dhe rezultatet qenë shumë të mira. Instruktorët e kurseve përkatëse do të shpreheshin që gratë e asistuar ishin të motivuara të përvetësonin njohuritë e dhëna në kurse sikurse ishin të ndërgjegjësuar për vlerën pozitive që mbarte ky kualifikim.

Ky projekt i realizuar në komunën Bërçullë ishte një mundësi e mirë kualifikimi profesional dhe jo vetëm atë. Përfshirja në aktivitetet social-kulturale të organizuara në kuadër të programit të shoqatës, si edhe takimet me specialistë të fushës gjinore ku u fol për probleme si SST, stereotipet gjinore, dhuna në familje, vetaktualizimi ishin shumë frytdhënëse.

“Çel një shteg në jetë” na ndihmoi të kuptojmë edhe më mirë situatën e grave në zonat rurale dhe të mendojmë për hapa të mëtejshëm që nxisin integrimin në komunitet.

Projekti u mbështet financiarisht nga Këshilli i Kishave Protestante në Zvicër dhe fondet u mbledhën nga Z. Patrice de Mestral.

**Brunilda Qevani,  
Punonjëse sociale**

## Letër falenderimi Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”

Quhem Redona Lleshi, jam lindur në Burrel, por kam ardhur dhe jam vendosur në Tiranë për arsye familjare. Prindërit e mi u divorcuan herët dhe këtu nisi fatkeqësia e familjes sonë. Unë isha në moshë fare të vogël kur familja jonë u shpërbë dhe nëna u martua dhe krijoi një familje tjetër. Po ashtu edhe babai. Qysh atëherë unë, së bashku me motrën, jetojmë në shtëpinë e dajës. Jeta për mua ka qenë tepër e vështirë, qoftë nga ana shpirtërore ashtu edhe nga ajo ekonomike. Kisha prirje dhe shumë dëshirë të vazhdoja shkollën, por pamundësia ekonomike më detyroi të mbaroja vetëm shkollën 8-vjeçare.



Rastësia dhe Zoti më ndihmuan të takoja Shoqatën “Shpresë për të Ardhmen”. Mendova të takoja personelin që punonte aty dhe t’u parashtroja vuajtjet dhe shqetësimet e mia. Mora guximin dhe shpreha problemet, shqetësimet e pafund që më mundonin. U pritja shumë njerëzishëm prej tyre. Aty gjeta shpresë dhe gjallëri, aty ndjeva se do të më ndihmonin.

Me ndihmën e kësaj shoqate unë mbarova kursin për parukeri. Më pas ndoqa kurset e trajnimit për hapje biznesi të organizuara nga shoqata dhe u financova për të nisur aktivitetin tim privat. Dhe kështu arrita të hapja parukerinë time.

E falenderoj përzemërsisht këtë Shoqatë dhe stafin e saj për ndihmesën e tyre humane.

**Me respekt,  
Redona Lleshi**

## Faleminderit Shpresë për të Ardhmen



### *Të dashur dhe të nderuar përgjegjës të Shoqatës "Shpresë për të Ardhmen"*

Në emër të nënave me fëmijë jetimë ju falenderojmë shumë për sensibilizimin dhe mbështetjen tuaj për fëmijët tanë. Ne ju jemi shumë mirënjohëse që po gëzoni sadopak këta jetimë në prag të festave të fundvitit, që edhe ata të mos i kenë gjithmonë sytë me lot teksa shohin bashkëmoshatarët e tyre të lumtur me prindërit për krahu. Si të vetme që jemi, ne nënat e jetimëve, pa për krahu dhe ndihmën tuaj dhe të komunitetit nuk mund t'u sigurojmë fëmijëve as bukën e gojës, pasi shumë nëna janë pa punë dhe ato pak të punësuara kanë paga të ulëta, ashtu siç janë pagat e shtetit dhe sidomos të grave pa arsimim.

Fëmijët tanë kanë shumë nevojë si për ushqim e veshmbathje ashtu edhe për shkollim që edhe ata të integrohen dhe të bëhen pjesë e denjë e shoqërisë. Shumë e

rëndësishme për ta është edhe buzëqeshja që u ka ngrirë në buzë. Faleminderit "Shpresë për të Ardhmen" që u kthyet buzëqeshjen fëmijëve tanë sot në këtë ditë.

Shpresojmë që për krahu dhe ndihma juaj për ne të vazhdojë edhe në të ardhmen. Urojmë që ju dhe familjet tuaja të jeni sa më të lumtur. Zoti ju begatofte dhe bekoftë me të mira! Mirësitë e tij të shumta qofshin për të gjithë ata që ndihmojnë jetimët dhe nënat e tyre! Falenderime të përzemërta dhe të sinqerta nga ne nënat e jetimëve.

**Në emër të nënave me fëmijë jetimë**  
**Dëshira Gjonaj**  
**Liljana Bako**  
**Vera Mullau**  
**Ibra Allushi**

## STATISTIKA ndër vite

Në total 1745 persona, 1406 meshkuj dhe 339 femra janë regjistruar në zyrën e Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” që nga Maji 1999 deri në Dhjetor 2008.

1362 përfitues, 1079 meshkuj dhe 283 femra kanë përfituar nga programi ynë i riintegrimi profesional dhe social që nga Maji 1999 deri në Dhjetor 2008.

*Statistika të vitit 2008*

Projektet	Nr. i përfituesve	Përqindja
Kape të Ardhmen	72	31,03
Albamar	59	25,43
VARRP	6	2,59
FoKaBi 2	40	17,24
Hidhe Hapin 2	55	23,71
Total	232	100,00


Kape të Ardhmen (**31,03**)

Albamar (**25,43**)

Hidhe hapin 2 (**23,71**)

FoKaBi 2 (**17,24**)

VARRP (**2,59**)



## *Përfituesit e Shoqatës thonë:*

Në kohën kur kisha nevojë, ndihma e Shoqatës qe shumë e vlefshme për të kapërcyer gjendjen e vështirë në të cilën ndodhesha. Tashmë kam një punë të mirë dhe jam e kënaqur me veten. Dhe kam vendosur të qendroj këtu.


**D. G. Durrës**

Mendoj se kjo Shoqatë i ka ardhur në ndihmë shumë personave vërtet në nevojë. Unë personalisht jam pothuajse i mirintegruar në tregun e punës dhe kjo është diçka pozitive dhe ka ardhur falë jush. Ju faleminderit.

**A. Z. Tiranë**

Është projekt për t'u përgëzuar. Një mënyrë ndihme sociale e financuar nga jashtë dhe e munguar nga institucionet tona shtetërore. Eksperienca zvicerane dhe puna shumëvjeçare e Shoqatës është një shembull për t'u zgjeruar edhe më shumë. Faleminderit.

**Gj. Dh. Berat**



### **"Shpresë për të Ardhmen"**

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 8, Ap.11, Tiranë • Tel: (04) 2 253 649; Tel/Faks: (04) 2 224 033  
E-mail: shprese@shprese.org • Web: www.shprese.org